

# LICENCË PËR FURNIZIM PUBLIK ME NGROHJE QENDRORE (ME KUSHTE)

**DHËNË:**

***"NGROHTORES SË QYTETIT TERMOKOS" SH.A.***

**Numri i Regjistrimit:  
ZRRE\_Li\_12/ 06**

## PASQYRA E PËRMBAJTJES

<b>PJESA I    TERMAT E LICENCËS</b> .....	2
<b>PJESA II    KUSHTET E LICENCËS</b> .....	2
Neni 1. Përkufizimet dhe Interpretimet .....	3
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit.....	4
Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve .....	5
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit.....	6
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin Matës, dhe Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.....	6
Neni 6: Siguria dhe Mbrojtja e Furnizimit.....	6
Neni 7: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit.....	7
Neni 8: Furnizimi me Njehsorë.....	8
Neni 9: Procedurat për Zbulimin dhe Parandalimin e Vjedhjes, Dëmtimit dhe Ndërhyrjes në Njehsorë.....	8
Neni 10: Informacione të Tjera që u Jepen Konsumatorëve.....	9
Neni 11: Shëndeti dhe Siguria .....	9
Neni 12: Puna.....	9
Neni 13: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve të të Licencuarit.....	9
Neni 14: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	10
Neni 15 : Shërbimet Publike të Detyrueshme.....	10
Neni 16: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së .....	10
Neni 17: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës .....	11
Neni 18: Masat dhe Gjobat Administrative .....	12
Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve .....	13

## **PJESA I    TERMAT E LICENCËS**

1. **Zyra e Rregullatorit të Energjisë (tani e tutje "ZRRE")**, në ushtrimin e autoritetit të vet të dhënë sipas Neneve 15.2(a), 28.2 (e) dhe 37 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, nenit 16.2 të Ligjit mbi Energjinë, Neneve 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore me anë të kësaj lëshon **Ngrohtores së Qytetit "TERMOKOS" SH.A** (tani e tutje duke iu referuar si "i Licencuari") licencën për **furnizimin me ngrohje qendrore** tek konsumatorët, për periudhën specifikuar në paragrafin 6, e cila i nënshtrohet Neneve dhe Kushteve të përcaktuar në Pjesën II (tani e tutje duke iu referuar si "Kushtet"). Territori i mbuluar prej kësaj Licence është Prishtina, tani e tutje do të referohet si "Territori".
2. I Licencuari është i obliguar që të veproj në pajtueshmëri me tërë Legjislacionin e aplikueshëm, Nenet dhe kushtet e kësaj licence.
3. I Licencuari do të:
  - a) shesë energji termike ndaj konsumatorëve jo të privilegjuar me çmime të rregulluar.
  - b) shesë energji termike tregtarëve;
  - c) shesë energji termike ndaj konsumatorëve të privilegjuar në përputhje me procedurat e krijuara nga ZRRE-ja;
  - d) blejë energji termike me çmime të parregulluara nga prodhuesit e tjerë;
  - e) faturojë dhe mbledhë pagesat prej konsumatorëve të vet;
  - f) merret me ankesat e konsumatorëve të vet;
  - g) marr pagesën për atë që i takon me kontratë
4. I Licencuari do të blejë energji termale nga Prodhuesit me kapacitet të instaluar më të madh se 1 MW, sipas Ligjit për Ngrohje Qendrore.
5. Kushtet u nënshtrohen ndryshimit ose përfundimit apo tërheqjes, në përputhje me termat e tyre dhe me nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë.
6. Kjo licencë do të hyjë në fuqi më 04 Tetor 2006 dhe, përveçse në rast se tërhiqet, do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe e vlefshme deri më 04 Tetor 2016 me mundësi vazhdimi sipas Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji \_\_\_\_\_.

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së) \_\_\_\_\_

## **PJESA II    KUSHTET E LICENCËS**

## **Neni 1. Përkufizimet dhe Interpretimet**

1. Për qëllim të kësaj licence, termat dhe shprehjet e renditura me poshtë, do të kenë kuptimin vijues:

*"Anëtar"* nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë;

*"Konsumator"* ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Kodi për mbrojtjen e konsumatorëve"* ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Pika e shpërndarjes"* është nënstacioni termik prej të cilit bartet ngrohja dhe mundësisht uji i nxehtë i rubinetit për përdorim shtëpiak të përdoruesit përfundimtar, dhe ku bëhet matja e ngrohjes me aparatura të përshtatshme matëse.

*"Shpërndarja"* ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Kodi i Shpërndarjes"* ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Konsumator i privilegjuar"* është konsumatori që është i lirë të blejë energji termike prej furnizuesit që zgjedh vetë.

*"Konsumator përfundimtar"* është një konsumator i cili blen energji termike për përdorim vetjak

*"Viti Financiar"* është periudha e raportimit të të Licencuarit për qëllime Rregullative dhe zakonisht përfshin periudhën prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm, përveç nëse specifikohet ndryshe me legjislacionin sekondar relevant të nxjerrë nga ZRRE-ja.

*"Ngrohja apo Energjia Termike"* ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Rrjeti i Shpërndarjes së Ngrohjes"* është sistemi i gypave që bart ngrohjen nga prodhuesi tek konsumatorit;

*"Ndërmarrje e Ngrohjes"* ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

*"Sistemi i Ngrohjes"* është sistemi i integruar dhe i kyçur i gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit.

*"Legjislacioni"* nënkupton Ligjin për Energji (2004/8), Ligjin për Energji Elektrike (2004/9), Ligjin për Ngrohje Qendrore dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që do të nxirret për të ekzekutuar legjislacionin primar e që do të rregullon sektorin e ngrohjes;

"*Kodi i matjes*" ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

"*Pajisjet matëse*" ka kuptimin e dhënë me Nenin 3.1 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

"*Konsumator jo i privilegjuar*" është një konsumator I cili është I detyruar të blejë energji termike prej furnizuesit publik;

"*Furnizues*" është personi i licencuar për furnizimin e ngrohjes qendrore;

"*Furnizim*" është shpërndarja dhe shtija ose rishitja e energjisë termike ndaj konsumatorëve

2. Termat e përdorur në këtë Licencë do të kenë të njëjtat kuptime si termat e përdorur në Legjislacion.
3. Duke iu referuar paragrafit 2, do të aplikohet çdo modifikim ose çdo ri-dekretim i legjislacionit që bëhet pas datës kur hyn në fuqi kjo licencë.
4. Përveçse nëse specifikohet ndryshe:
  - a) çdo referim ndaj një Neni me numër ose Shtojce me numër, është përkatësisht referim ndaj Nenit ose Shtojcës që mban të njëjtin numër në këtë licencë;
  - b) çdo referim ndaj një paragrafi me numër është referim ndaj paragrafit që mban të njëjtin numër në Neni ose Shtojcën ku bëhet referimi.
5. Subjekti ose titulli i ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi nuk do të ndikojë ndërtimin e kësaj të fundit.
6. Nëse të Licencuarit i vendoset një detyrim me një afat përfundimtar specifik në lidhje me kryerjen e detyrave, ai detyrim do të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa paragjykim ndaj të gjitha të drejtave dhe masave administrative dhe gjobave që mund t'i vendosen të Licencuarit nëse ky i fundit nuk arrin të kryejë detyrën brenda afatit kohor.
7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në rast të çdo dokumenti, udhëzimi ose njoftimi që do të dorëzohet, ose edhe shërbimi që do të kryhet në përputhje me këtë licencë dhe me udhëzimet e nxjerra nga ZRRE-ja.

## **Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit**

### **Kushti 1**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë llogaritë vjetore rregullative në përputhje me udhëzimet e përkohshme të ZRRE-së në raportimet rregullative dhe do ti dërgoj

ZRRE-së një kopje të deklaratës/llogarive të audituara vjetore të përgatitur sipas orarit kohorë/legjislacionit sekondar relevant të lëshuar nga ZRRE-ja.

2. Në përputhje me Nenin 6.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore, i Licencuari në kontabilitetin e vet të brendshëm do të mbajë llogari të ndara të kontabilitetit për biznesin e Furnizimit në tërësi, si dhe llogaritë e ndara për aktivitetet e furnizimit ndaj konsumatorëve të privilegjuar dhe jo të privilegjuar (si dhe për aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me ngrohjen), I Licencuari gjithashtu do të mbajë në kontabilitetin e tij të brendshëm, llogari të ndara për kontratat komerciale me konsumatorët e tij për instalimin, servisimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit dytësor në pikën e shpërndarjes, në përputhje me Nenin 22 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore. I cili në rast se kërkohet herë-pas-herë prej ZRRE-së, i Licencuari duhet të dorëzojë llogaritë e tilla në ZRRE në formën dhe datën e specifikuar nga kjo e fundit.
3. Udhëzimet përkohshme të raportimit Rregullativ apo urdhëresat e dhëna nga ZRRE-ja sipas paragrafit 2, mes të tjerash mund të:
  - a) Specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e përfitimit dhe humbjes, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, deklaratat e rrjedhjes së parave të gatshme dhe deklaratat e sasive të të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave, ose furnizimet që, ose janë ngarkuar nga një biznes tjetër, ose i janë ngarkuar këtij të fundit, ose janë përcaktuar nga alokimi dhe ndarja midis biznesit të konsoliduar të Furnizimit dhe ndonjë biznesi tjetër.
  - b) Specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, kostove, aseteve ose borxheve dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, kostot, asetet dhe borxhet që i atribuohen aktiviteve të specifikuara.
  - c) Specifikojë parimet e kontabilitetit për rregullatorin (përfshirë bazën për alokimin e kostove).
4. Për sa i përket deklaratave të kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifave, shpërndarjen ose caktimin e tarifave të aplikuara në lidhje me vitin financiar paraprak, përveçse në rast se ZRRE-ja ka nxjerrë udhëzime për qëllimet e këtij Kushti të cilat e udhëzojnë të Licencuarin të ndryshojë këto baza, ose nëse ZRRE-ja ka dhënë aprovim paraprak me shkrim për ndryshimin në fjalë.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të lëshuar nga ZRRE-ja e për qëllim të këtij Neni.

### **Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve**

1. I Licencuari do të sigurojë që biznesi i Furnizimit (apo ndonjë pjesë biznesit të Furnizimit) nuk do të jap dhe as nuk do të marrë subvencione ose ndër-subvencione (direkte ose indirekte) nga asnjë biznes tjetër i të Licencuarit ose nga ndonjë Vartës apo sipërmarrje tjetër e të Licencuarit apo ndonjë person tjetër.

2. I Licencuari do të sigurojë që biznesi i Furnizimit për konsumatorët e privilegjuar nuk do tu jap apo marrë nga biznesi i tij i Furnizimit të konsumatorëve jo të privilegjuar ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (të drejtpërdrejt apo tërthortë)

#### **Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit**

I Licencuari nuk do të furnizojë ose nuk do të ofrojë të furnizojë energji termike ndaj asnjë blerësi ose personi që kërkon të bëhet blerës, në lidhje me çmimin që është materialisht më i favorshëm ose më pak i favorshëm se çmimi me të cilin furnizuesi furnizon ose ofron të furnizojë energji termike kundrejt blerësve të krahasueshëm. Për këto qëllime, do të merren në shqyrtim rrethanat e furnizimit ndaj këtyre blerësve, përfshirë (pa kufizim) vëllimet, faktorët e ngarkesës, kushtet e interpretueshmërisë, datat dhe kohëzgjatjet e marrëveshjeve përkatëse.

#### **Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin Matës, dhe Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

##### **Kushti 2:**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, pas konsultimit me të Licencuarit tjerë relevant, ZRRE-ja mund ti jap të Licencuarit një orar kohorë për të implementuar këtë Nen. Orari i tillë kohor mund të zbatohet dhe do të ketë shtrirje në ato pjesë të Kodeve siç precizohet në atë orar.

1. I Licencuari do të jetë në përputhje me dispozitat të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodin të Matjes, për aq sa janë të zbatueshëm.
2. I Licencuari do të jetë në pajtim me Rregullin e Kushteve të Përgjithshme të Furnizimit me Energji që është nxjerrë nga ZRRE-ja.

#### **Neni 6: Siguria dhe Mbrojtja e Furnizimit**

1. I Licencuari do të mbajë çdo konsumator të informuar rreth adresës postare, numrit të telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të shërbimit të informacionit i cili është themeluar dhe funksionon për qëllimin e marrjes së raporteve nga çdo person rreth ndonjë çështjeje ose incidenti, që:
  - a) shkakton ose ka gjasa të shkaktojë rrezik ose kërkon vëmendje urgjente, në lidhje me furnizimin ose shpërndarjen e ngrohjes qendrore; ose
  - b) ndikon, ose ka gjasa të ndikojë sigurinë, disponueshmërinë ose cilësinë e shërbimit të sistemit të shpërndarjes përmes të cilit bëhet furnizimi i konsumatorit përkatës me ngrohje qendrore.
  - c) ka të bëjë me çdo ankesë tjetër të konsumatorit, ose informacion që kërkohet nga ana e konsumatorit.
2. Shërbimi i informacionit që referohet në paragrafin 1, duhet:
  - a) t'i jepet konsumatorit pa pagesë;
  - b) të jetë në dispozicion për të marrë dhe proceduar raporte dhe informacione

- telefonike gjatë gjithë kohës për çdo ditë të secilit vit; dhe
- c) të vihet në funksion jo më vonë se në datën e specifikuar nga ZRRE-ja.
3. I Licencuari mund të kryejë detyrën që i vendoset në paragrafin 1 duke i siguruar çdo konsumatori informacionin e kërkuar:
- a) me rastin e fillimit të marrjes së furnizimit të të licencuarit nga ana e konsumatorit; dhe pas kësaj,:
- (i) nëse faturat ose deklaratat në lidhje me tarifat për furnizimin e energjisë termike i jepen konsumatorit çdo tre muaj ose më shpesh (për aq sa është e mjaftueshme që informacioni të përfshihet në ndonjë faturë ose deklaratë, ose të shoqërohet me to); ose
- (ii) në ndonjë rast tjetër, në baza vjetore;
- b) dhe duke botuar këto informacione në atë mënyrë që siguron publicitet të përshtatshme për të.
4. I Licencuari do të ndërmarrë hapa për të informuar secilin prej konsumatorëve të vet rreth ndryshimeve të adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit ose adresës së postës elektronike të shërbimit që është referuar në paragrafin 1, përpara se ky ndryshim të hyjë në fuqi.

#### **Neni 7: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit**

1. I Licencuari do të ushtroj aktivitetin e licencuar në mënyrë efikase, ekonomike dhe në mënyrë të koordinuar.
2. I Licencuari do të marrë të gjithë masat e nevojshme për të siguruar dhe zbatuar të gjithë detyrimet që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm, ose që kanë të bëjnë me këtë legjislacion, këtë licencë dhe me marrëveshjet ku është palë.
3. I Licencuari do të përgatisë një kontratë komerciale dhe do t'ia propozojë këtë konsumatorëve të privilegjuar që kanë zgjedhur të furnizohen nga Furnizuesi Publik, në përputhje me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, dhe të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
4. I Licencuari brenda afatit të paraparë me Ligjin mbi Ngrohjen Qendrore, do të përgatisë Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe do ta dorëzojë për aprovim në ZRRE.
5. I Licencuari do të lidhë kontrata afatgjate të blerjes me prodhuesit, në atë masë që nevojitet për të garantuar furnizim të mjaftueshëm, në përputhje me Nenin 19 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore. Këto kontrata i nënshtrohen aprovimit dhe monitorimit të ZRRE-së.
6. I Licencuari do t'i japë prioritet blerjes së energjisë termike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, në përputhje me Nenin 12.2 dhe 12.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.



### **Neni 8: Furnizimi me Njehsorë**

1. Energjia termike e shitur nga i Licencuari konsumatorëve do të matet duke përdorur aparatura matëse sipas procedurës së përcaktuar në Kodin Matës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ngrohje Qendrore.
2. Kodi Matës do të nxjerrët nga Distributori dhe aprovohet nga ZRRE-ja në përputhje me Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.

### **Neni 9: Procedurat për Zbulimin dhe Parandalimin e Vjedhjes, Dëmtimit dhe Ndërhyrjes në Njehsorë**

1. I Licencuari di të marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të zbuluar dhe parandaluar:
  - a) vjedhjen e energjisë termike në ndërtesat ku janë furnizua nga ai;
  - b) dëmtimin ose defektin e ndonjë njehsori të energjisë termike përmes të cilit furnizohet ndërtesa;
  - c) ndërhyrjen me ndonjë njehsor të energjisë termike përmes të cilit furnizohet ndërtesa; dhe
  - d) ndonjë konsum të paregjistruar të energjisë termike në ndërtesat që furnizohen nga ai.
2. Sa më shpejt që të jetë e mundur, i Licencuari do të informojë pronarin e tubacionit ose njehsorët përkatës, rreth çdo incidenti ku ka arsye të besojë se:
  - a) ka ndodhur një dëmtim ose ndonjë defekt në ndonjë tubacion ose njehsor; ose
  - b) ka pasur ndërhyrje në ndonjë njehsor për të ndryshuar regjistrin e tij ose për të parandaluar regjistrimin e rregullt të sasisë së ngrohjes së furnizuar; ose
  - c) konsumi i energjisë termike në ndërtesat e furnizuara nga ai nuk është regjistruar.
3. Nëse i Licencuari ka arsye për të besuar se ndonjë incident që i është raportuar pronarit në përputhje me paragrafin 2, është shkaktuar nga akti kriminal i ndonjë personi, i Licencuari duhet t'i sigurojë pronarit këtë informacion siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme për qëllimet e hetimit të incidentit dhe për zgjidhjen e problemeve të sigurisë që mund të rrjedhin prej tij.
4. I Licencuari do të informojë pronarin për politikën e vet në lidhje me incidentet e llojit të referuar në paragrafin 3, dhe në veçanti për rrethanat në të cilat kërkohet që incidentet të riparohen nga pronari, përmes përdorimit të:
  - a) zëvendësimit të njehsorëve alternativë; dhe
  - b) shkëputjen e furnizimit të ndërtesës ku ka ndodhur incidenti.

5. Në këtë Nen:

"Vjedhje" do të thotë përdorim i pandershëm, shpërdorim ose devijim i energjisë

termike.

### **Neni 10: Informacione të Tjera që u Jepen Konsumatorëve**

1. I Licencuari do t'i mbajë të informuar secilin nga konsumatorët e vet (përveç nëse konsumatori i fundit merr furnizim të pamatur) mbi sasinë e energjisë termike, e cila që prej informimit të fundit të konsumatorit, në regjistrat e vet tregohet ashtu si është konsumuar nga konsumatori, në përputhje me njehsorin përmes të cilit furnizohet konsumatori i fundit.
2. I Licencuari do të mbajë të informuar secilin nga konsumatorët e vet:
  - a) se ZRRE-ja mund të ndihmojë në zgjidhjen e ankesave të cilat nuk i ka zgjidhur i Licencuari sipas kënaqësisë së konsumatorit; dhe
  - b) se si mund të kontaktohet ZRRE-ja.
3. I Licencuari mund të kryejë detyrat e veta sipas paragrafëve 1 dhe 2 duke siguruar informacione të rëndësishme në secilën faturë ose deklaratë që i jepet konsumatorit, në lidhje me tarifat për furnizimin me energji termike, dhe çdo vit do të informojë secilin konsumator të cilit nuk i janë dhënë fatura ose deklarata të tilla.

### **Neni 11: Shëndeti dhe Siguria**

I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat dhe pronat nga lëndimi dhe dëmtimi që mund të shkaktohet prej të Licencuarit gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar.

### **Neni 12: Puna**

I Licencuari do të bjerë në pajtim me tërë legjislacionin e aplikueshëm mbi marrëdhënie pune, qofshin ata në fuqi prej kësaj date, ose në të ardhmen.

### **Neni 13: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve të të Licencuarit**

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mbajë një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së këtë regjistër çdo vit jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të tjetërsojë apo braktis kontrollin mbi cilindo aset të rëndësishëm poqëse tjetërsimi apo lërja pas dore e kontrollit do të ndikojë në aftësinë për të kryer obligimet e tija, apo nëse aset i ka vlerën zëvendësuese mbi 100,000.00 Euro.
3. Në rast kur i Licencuari kërkon të tjetërsojë disa asete që janë pronë e tij ose të përdorura prej tij, si dhe burime të tjera të përdorura për të kryer aktivitetin e licencuar, është i detyruar të njoftojë me shkrim ZRRE-në. I Licencuari mund të realizojë tjetërsimin e ndonjë asemi vetëm pas aprovimit me shkrim nga ZRRE-ja.
4. E njëjta si në paragrafin 1 aplikohet ndaj dhënies për shfrytëzim të asetëve ose burimeve të tjera të shfrytëzuara për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

5. Në këtë Nen:

“*Aseti*” konsiderohet të jetë çdo pajisje e paluajtshme ose e luajtshme me vlerë të rëndësishme, që përdoret për ushtrimin e aktivitetit të Furnizimit.

“*Tjetërsimi*” nënkupton çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënie, ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe “tjetërsimi” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

#### **Neni 14: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë synim për ndryshim në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE ja nuk e aprovon.

#### **Neni 15 : Shërbimet Publike të Detyrueshme**

I Licencuari do të kryejë çdo detyrim publik i cili mund ti ngarkohet nga ZRRE-ja sipas Nenit 51 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe dispozitave të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

#### **Neni 16: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE**

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE sa herë dhe si të kërkojë kjo e fundit, informacionin si dhe raportet që konsiderohen si të nevojshme sipas Neneve të kësaj Licence për qëllimet e kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar sipas Legjislacionit, në përputhje me Nenin 29 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
2. Informata do të përgatitet në nivel të auditimit ashtu siç mund të kërkojë nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
3. Autoriteti i ZRRE-së për të kërkuar informacion sipas paragrafit 1 nuk limiton kompetencat e ZRRE që të kërkojë edhe informacionin që konsiderohet konfidencial sipas çdo Neni apo Kushti tjetër të kësaj Licence ose sipas Legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që një informatë e caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënoj atë informatë si konfidencial dhe ta arsyetoj ZRRE-së kërkesën e tij.
5. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së raportet tremuajshe dhe vjetore mbi veprimtarinë e Furnizimit dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës e që është në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerr nga ZRRE-ja.
6. Dispozitat e çdo kontrate të furnizimit (përfshirë kontratat për blerjen afatgjatë që referohen në Nenin 7, paragrafi 5, dhe me përjashtim të kontratave komerciale të

dhëna në Nenin 22.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore) duhet të njoftohen në ZRRE përpara vënies në funksion të kësaj marrëveshjeje, në mënyrë që të aprovohet dhe monitorohet nga ZRRE-ja.

7. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së detajet e çdo ndryshimi në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë Licence.
8. Në këtë Nen:

**"Informacioni"** është material në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

### **Neni 17: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë sipas Nenit 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nëse obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të pa lakmueshëm për shkak të përfundimit. Përfundimi i licencës do të ndermirret në rast të:
  - a) skadimit të afatit të licencës;
  - b) me kërkesë të ndërmarrjes së licencuar të ngrohjes lidhur me licencën e tij;
  - c) shpërbërjen e personit juridik që mban licencën;
  - d) me vendim të gjykatës që deklaron falimentimin e të licencuarit, ose me anë të vendimit të gjykatës për të përfunduar aktivitetin e furnizimit me energji për shkak të deklaratës së të licencuarit rreth falimentimit të tij;
  - e) nëse një aktivitet i licencuar i furnizimit me energji termike nuk është drejtuar për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç në rast kur pezullimi i aktivitetit është kryer me miratim të ZRRE-së;
  - f) nëse janë përmbushur dispozitat e Nenit 44 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë, dhe
  - g) nëse shuma e taksës që duhet paguar nuk është paguar për tridhjetë (30) ditë pasi është dashur të paguhet, dhe mbetet e papaguar për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh të tjera pasi të Licencuarit i është dërguar njoftimi me shkrim nga ZRRE-ja se pagesës i ka kaluar afati.
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet vijuese, siç përcaktohet në Nenin 44.5 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë, me kusht që detyrimet e të licencuarit të kryhen nga një i licencuar tjetër, ose që konsumatorët të mos jenë në disavantazh nga kjo tërheqje:
  - a) i Licencuari nuk i plotëson kushtet e Neneve apo obligimet nga licenca apo edhe i shkel ato, dhe se ai mosplotësim ato shkelje nuk është ndrequr brenda afatit të caktuar nga ZRRE, apo ka dëmtuar seriozisht kualitetin, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari ishte i obliguar ta ofroj;
  - b) monitorimi i licencës nga ZRRE-ja ose Inspektorati i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave gjen dështim në përmbushjen e kritereve administrative, dhe

ky dështim nuk është ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja;

- c) i licencuari ka paraqitur informacione të rreme mbi të cilat është bazuar dhënia e licencës.
3. Në përputhje me Nenin 35 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE-ja mund të modifikojë licencën në rastet në vijim:
- a) me kërkesë të të Licencuarit;
  - b) nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin e ngrohjes në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit ose sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, ose në lidhje me mbrojtjen e ambientit.
  - c) në mënyrë që të plotësohen kërkesat e reja që janë përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet, rregulloret vendore, si dhe në legjislacione të tjera të aplikueshme;
  - d) si sanksion për shkeljen dhe kushteve dhe termave të licencës, sipas Nenit 44 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

### **Neni 18: Masat dhe Gjobat Administrative**

1. Në rast të shkeljes së ndonjë dispozite të legjislacionit dhe të ndonjë Neni ose kushti të kësaj licence si dhe ndonjë udhëzimi që ZRRE-ja i ka dhënë të licencuarit, ZRRE-ja do të ketë autoritetin që sipas Nenit 56.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit mbi Masat dhe Gjobat Administrative, që ose të parandalojë të licencuarin që të përsërisë veprimin e paligjshëm, ose në rast se veprimi është ndaluar, të nxjerrë një vendim rregullativ ku kërkohet që të ndërmerret një veprim i caktuar ose të vendosen gjoba administrative ndaj të Licencuarit dhe/ose anëtarëve të Bordit të të Drejtorëve dhe/ose ekzekutivit.
2. Përpara nxjerrjes së një gjobe, ZRRE-ja do të japë të Licencuarit njoftimin për shkeljen e licencës dhe do t'i japë këtij të fundit mundësinë për t'u përgjigjur me shkrim brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh prej njoftimit, në mënyrë që të ndreqë shkeljen.
3. Gjoba do të vihet të të Licencuarit në përputhje me Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin mbi Masat dhe Gjobat Administrative.
4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Rregullin për Gjobat dhe Masat Administrative. Sidoqoftë nëse gjoba nga paragrafi 3 i ngarkohet të Licencuarit ajo nuk mund ta tejkalojë 15% e të ardhurat nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraprak.
5. Nëse gjoba nga paragrafi 3 i është ngarkuar anëtarit të Bordit të Drejtorëve apo ekzekutivit të të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkalojë 300% e pagës mujore që ai person ka pranuar nga i Licencuari.
6. Në rast të shkeljeve të përsëritura, gjoba e vendosur mund të jetë tri (3) herë më e madhe se shumta e autorizuar në paragrafët 4 ose 5.

7. Në përputhje me këtë Nen, kur ZRRE-ja vendos një gjobë, duhet të marrë parasysh shkallën e dëmit social të veprimit, sjelljen e mëparshme të të Licencuarit apo personit në fjalë si dhe situatën të Licencuarit apo personit në fjalë.
8. Nëse gjoba e vendosur nga ZRRE-ja nuk paguhet, ZRRE-ja do të fillojë procedurat gjyqësore për mbledhjen e gjobës si borxh civil.

#### **Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo mosmarrëveshje që lind për shkak të aktivitetit të licencuar, do të zgjidhet në përputhje me Rregullin mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, që është nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me modifikimin, tërheqjen ose përfundimin e licencës, si dhe ato që kanë të bëjnë me gjobat që pasojnë nga shkeljet e licencës ose të legjislacionit të aplikueshëm, mund të apelohej nga i Licencuari në gjykatën e juridiksionit kompetent.